

SNISA 10

INTOSAI



Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, SNISA, lëshohen nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI, Për më shumë informacion vizitoni [www.issai.org](http://www.issai.org)

## **Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve**

Komisioni Profesional për Standarde të INTOSAI-it

Sekretariati i KPS-së

Rigsrevisionen • Landgreven 4 • P.O. Box 9009 • 1022 Copenhagen K • Denmark

Tel.:+45 3392 8400 • Fax:+45 3311 0415 •E-mail: [info@rigsrevisionen.dk](mailto:info@rigsrevisionen.dk)

Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-it - RECHNUNGSHOF

(Gjykata Austriake e Auditimit)

DAMPFSCHIFFSTRASSE 2

A-1033 VIENNA

AUSTRI

Tel.: ++43 (1) 711 71 • Fax: ++43 (1) 718 09 69

E-MAIL: [intosai@rechnungshof.gv.at](mailto:intosai@rechnungshof.gv.at)

Faqja e internetit: <http://www.intosai.org>

## **Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve**

### **Preambula**

Nga Kongresi i XIX i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) i mbajtur në Meksikë:

Duke pasur parasysh që përdorimi i drejtë dhe efikas i fondeve dhe resurseve publike përbën një nga parakushtet e trajtimit të duhur të financave publike si dhe trajtim më efektiv të vendimeve të Autoriteteve përgjegjëse.

Pasi që Deklarata e Lima-së mbi Udhëzimet e Rregullave të Auditimit (Deklarata e Lima-së) thekson se Institucionet Supreme të Auditimit (ISA-të) mund ti përmbushin detyrat e tyre vetëm nëse ato janë të pavarura nga entiteti i audituar dhe janë të mbrojtur nga ndikimi i jashtëm.

Kështu që, për të arritur këtë objektiv, është e domosdoshme të ketë demokraci të shëndoshë që nënkupton se çdo vend duhet të ketë një ISA, pavarësia e të cilit garantohet me Ligj.

Ndonëse Deklarata e Lima-së e pranon që Institucionet Shtetërore nuk mund të jenë të pavarura në mënyrë absolute, më tej pranon se ISA-të duhet të kenë pavarësi funksionale dhe organizative të nevojshme për të kryer mandatin e tyre.

Edhe pse përmes zbatimit të parimeve të pavarësisë, ISA-të mund ta arrin pavarësinë përmes mjeteve të ndryshme duke përdorur mbrojtje të ndryshme.

Ndonëse zbatimi i dispozitave të përfshira këtu shërben për të ilustruar parimet e që konsiderohen si ideale për pavarësinë e ISA. Është e njohur se asnjë ISA aktualisht nuk i ka zbatuar plotësisht këto dispozita, për këtë, praktikat tjera të mira për të arritur pavarësinë janë të paraqitura në Udhëzimet shoqëruese.

### **VENDIMET:**

Dokumenti i njohur si “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë” duhet të adoptohet, publikohet dhe të shpërndahet.

### **E Përgjithshme**

Institucionet Supreme të Auditimit zakonisht njohin tetë parime kryesore, që rrjedhin nga Deklarata e Lima-së dhe vendimet e marra në Kongresin e XVII të INTOSAI-it (në Seul, Koreja Jugore), si kërkesa themelore të auditimit të duhur të sektorit publik.

#### **Parimi 1**

**Ekzistimi i një Kornize efektive dhe të përshtatshme kushtetuese/statusore/ligjore dhe zbatimin *de facto* e dispozitave të kësaj kornize.**

Është i nevojshëm një Ligj i cili e precizon, në mënyrë të detajuar, nivelin e Pavarësisë së ISA.

#### **Parimi 2**

**Pavarësia e Udhëheqësve dhe Anëtarëve të ISA-të ( të institucioneve kolegjiale), përfshirë këtu sigurinë e zotërimit dhe imunitetit ligjor për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të duhur.**

Ligji në fuqi thekson kushtet për emërimet, ri-emërimet, punësimin, largimin dhe pensionimin e Udhëheqësve të ISA-të dhe anëtarëve të institucioneve kolegjiale të cilët janë:

- Emëruar, ri-emëruar, apo larguar nga një proces që garanton pavarësinë nga Organet Ekzekutive (shih ISSAI – 11 Udhëzimet dhe Praktikat e Mira që ndërlidhen me Pavarësinë e ISA-ve);
- Emërimet për periudha të caktuara dhe të pacaktuara, për tu lejuar atyre që të kryejnë mandatet e tyre pa frikë dhe shpagim; dhe
- Imun ndaj çfarëdo ndjekje për ndonjë vepër, që i takon së kaluarës apo kohës së tashme që rezulton nga kryerja e detyrave të tyre pa marrë parasysh rastin.

### **Parimi 3**

**Një mandat i mjaftueshëm, i gjerë dhe liri të plotë veprimi, në kryerjen e funksioneve të ISA-ve**

ISA-të duhet të autorizohen që të auditojnë

- Përdorimin e parave publike, burimet, apo pasuritë, nga pranuesi apo përfituesi pa marrë parasysh natyrën e tij ligjore;
- Inkasimin e të hyrave që ja kanë borxh Qeverisë apo entiteteve publike;
- Ligjshmëria dhe Rregullsia e llogarive të Qeverisë ose entiteteve publike;
- Cilësia e menaxhimit financiar dhe raportimi; dhe
- Ekonomizimi, efikasiteti, efektiviteti i operacioneve të qeverisë dhe entiteteve publike.

Përveç se kur një gjë e tillë kërkohet me Ligj, ISA-të nuk auditojnë politikat qeveritare dhe ato të entiteteve publike por e kufizojnë veten në auditimin e implementimit të politikave.

Përkundër kësaj, duke i respektuar Ligjet e dekretuara nga legjislatura e cila i aplikohet atyre, ISA-të janë të liruara nga te drejtuarit dhe interferenca e Legjislaturës apo Ekzekutivit në

- përzgjedhjen e çështjeve të auditimit;
- planifikim, programim, ekzekutim, raportim, dhe kryerjen e auditimeve;
- organizimin dhe menaxhimin e zyrës; dhe
- zbatimin e vendimeve të tyre ku aplikimi i sanksioneve është pjesë e mandatit të tyre.

ISA-të në asnjë mënyrë, nuk bën të jenë të involvuar, me menaxhmentin e organizatës ku janë duke kryer auditimin.

ISA-të duhet të sigurojnë që stafi i tyre nuk krijon marrëdhënie shumë të afërta me entitetet ku janë duke kryer auditimin, në mënyrë që të jenë sa më objektiv dhe të duken objektiv.

ISA-të duhet të ketë liri të plotë veprimi në shkarkimin e përgjegjësive të tyre, duhet të bashkëpunojnë me Qeveritë apo entitetet publike të cilët përpiqen të përmirësojnë shfrytëzimin e fondeve publike.

ISA-të duhet të punojnë dhe të përdorin standardet e auditimit dhe kodin etik bazuar në dokumentet zyrtare të INTOSAI, Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe standardeve-organeve themeluese të pranuara.

ISA-të duhet të dorëzojnë raportin e aktiviteteve vjetore organit ligjvënës dhe organeve tjera shtetërore – siç kërkohet me Kushtetutë, statusit apo ligjit – të cilin raport duhen ta vë në dispozicion për publikun.

#### **Parimi 4**

##### **Qasja e pakufizuar në informata**

ISA-të duhet të kenë kompetenca adekuate që të sigurojnë me kohë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të kenë qasje të pakufizuar tek të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme, për shkarkimin e duhur të përgjegjësive të tyre të parapara me ligj.

#### **Parimi 5**

##### **E drejta dhe obligimi për të raportuar për punën e tyre**

ISA-të nuk duhen të kenë kufizime për të raportuar mbi rezultatet e punës së tyre audituese. Sipas Ligjit ata janë të obliguar që të raportojnë së paku njëherë në vit për rezultatet e punës së tyre.

## **Parimi 6**

### **Liria për të vendosur përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit, për t'i publikuar dhe për t'i shpërndarë ato**

ISA-të kanë liri për të vendosur në lidhje me përmbajtjen e raporteve të tyre të auditimit.

ISA-të kanë liri që të japin vërejtje dhe rekomandime në raportet e tyre të auditimit, duke pas parasysh, aty kur është e nevojshme edhe pikëpamjet e entitetit të audituar.

Ligji specifikon kërkesa minimale raportuese të auditimit nga ISA-të dhe aty ku është e nevojshme, specifikon çështje të cilat janë subjekt i opinionit zyrtar të auditimit ose certifikatës.

ISA-të kanë liri të vendosin për kohën e raporteve të tyre të auditimit përveç në rastet kur kërkesat specifike të raportimit përshkruhen me Ligj.

ISA-të mund të parashtrajnë kërkesa të veçanta për hetime ose auditime sipas Ligjit, si tërësi, ose një prej komisioneve të saja apo edhe Qeverisë.

ISA-të kanë liri të publikojnë dhe të shpërndajnë raportet e tyre, prej momentit kur raportet dërgohen zyrtarisht tek autoriteti i caktuar- siç është e kërkuar me Ligj.

## **Parimi 7**

### **Ekzistimi i mekanizmave efektiv rreth rekomandimeve të ISA- ve**

ISA-të dërgojnë raportet organit ligjvënës, komisionit të tij, apo bordit qeverisës të të audituarve, aty ku është e nevojshme, për rishikim dhe zbatim të rekomandimeve të veçanta për veprime korrektuese.

ISA-të kanë sistemin e vet të brendshëm për të siguruar se entitetet e audituara i adresojnë në mënyrë të drejtë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre gjithashtu edhe ato të dhëna nga organit ligjvënës, komisionit të tij, apo bordit qeverisës të të audituarve, aty ku është e nevojshme.

ISA-të dërgojnë raportet e tyre organit ligjvënës, komisionit të tij, apo bordit qeverisës të të audituarve, aty ku është e nevojshme, për shqyrtim dhe veprim edhe atëherë kur ISA-të e kanë fuqinë e vet ligjore për zbatim dhe sanksionim.

## **Parimi 8**

### **Autonomia financiare dhe menaxheriale/administrative dhe kapaciteti i burimeve njerëzore, materiale dhe ato monetare**

ISA-të duhet të posedojnë burimet e nevojshme dhe të arsyeshme njerëzore, materiale dhe monetare ku organi ekzekutivi nuk duhet ta kontrolloj apo udhëheq qasjen e drejtpërdrejtë ndaj këtyre burimeve. ISA-të menaxhojnë buxhetin e vet dhe bëjnë alokimin e tij në mënyrë të duhur.

Organi ligjvënës apo një nga komisionet e tij është përgjegjës për të siguruar se ISA-të kanë burime të mjaftueshme për të përmbushur mandatin e vet.

ISA-të kanë të drejtë të bëjnë kërkesë të drejtpërdrejtë organit ligjvënës nëse burimet e siguruar nuk mjaftojnë për të përmbushur mandatin e vet.